**VENDIM**
**Nr.77, datë 30.11.2011**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE SHTESË NGA BANKA "SOCIETE GENERALE ALBANIA" SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe të nenit 43 shkronja "e" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja "ç", të nenit 54, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga banka "Societe Generale Albania" sh.a. të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:

a) Marrjen e angazhimeve;

b) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:

i) letra me vlerë të transferueshme;

ii) instrumente të tjera të negociueshme dhe aktive financiare, duke përfshirë veprimet me arin.

c) Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit;

d) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e radhitura më sipër.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të bankës "Societe Generale Albania" sh.a., pas kryerjes së ndryshimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Ardian Fullani**